Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 841/2026
Data: 30.06.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), Nenin 7 paragrafi 2, të Rregullores 001Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve e miratuar me datë 31.07.2025 nga Kuvendi i Komunës, më qellim të themelimit të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për përkrahje financiare në kuadër të Zyrës së Kryetarit, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për përkrahje financiare në kuadër të Zyrës së Kryetarit dhe në Komision caktohen:

1. **Alketa Bytyçi,** Kryesuese e Komisionit;
2. **Liliana Frrokaj,** anëtare;
3. **Ardon Arifaj,** anëtar.

2. Anëtare rezervë caktohet: **Fatjona Nurçaj**.

3. Komisioni i lartcekur obligohet t`i shqyrtoj të gjitha kërkesat për përkrahje financiare tw paraqitura pranë Zyrës së Kryetarit sipas Rregullores 001Nr.146/2025 për Ndarjen e Subvencioneve; për çdo kërkesë Komisioni harton procesverbal si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit;
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

UD.Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim METAJ

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 840/2026
Data: 30.06.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën 06Nr-553-18355 të datës 05.06.2026 të parashtruar nga Valon Thaqi nga fshati Staradran Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për kompensim te derivateve për transport ne shërbimin e Onkologjisë pran QSKUK-së me procesverbal. Nr.195/2026 të datës 30.06.2026 nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 06Nr-553-18355 e datës 05.06.2026 e parashtruar nga Valon Thaqi për përkrahje me karburant për trajtimin për shërbimin ne Onkologji ne QSKUK-së për trajtimin e kimioterapisë për prindin ne QKUK dhe përkrahet për **(10)fraksione** nga 15 litra karburant për një seancë, dhe i ndahen **njëqindepesëdhjetë (150)** litra karburant.

2. Obligohet Zyrtari i transportit që Valon Thaqi të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Valon Thaqi
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

UD.Udhëheqës i Sektorit Ligjor
Afrim METAJ

Kryetari i Komunës
z.Ilir FEKATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr. 839/2026
Data: 30.06.2026

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën 06Nr-553-20047 të datës 18.06.2026 të parashtruar nga Elvisa Destanović nga fshati Dobrushë Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për kompensim te derivateve për transport ne shërbimin e Onkologjisë pran QSKUK-së me procesverbal. Nr.194/2026 të datës 29.06.2026 nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 06Nr-553-20047 e datës 18.06.2026 e parashtruar nga Elvisa Destanović për përkrahje me karburant për trajtimin për shërbimin ne Onkologji ne QSKUK-së për trajtimin e kimioterapisë ne QKUK për nënën Munirka Destanović dhe përkrahet për **(20)fraksione** nga 15 litra karburant për një seancë, dhe i ndahen **treqind (300)** litra karburant.

2. Obligohet Zyrtari i transportit që Elvisa Destanović të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Elvisa Destanović
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

UD.Udhëheqës i Sektorit Ligjor
Afrim METAJ

Kryetari i Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOG
REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.838/2026
Data: 30.06.2026

Duke vendosur sipas njoftimit Nr.403/26 të datës 30.06.2026 të ndërmjetësuar nga drejtoresha e SHFMU-së "Bajram Curri" në Istog për konfirmimin e pushimit të lehonisë për mësimdhënësen e mësimit klasor (1-5) znj.Gentiana Hasanaj, lidhur me këtë Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 49. pika 1. e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 13 Rregullores (QRK) NR. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik merr këtë:

V E N D I M

I. znj.Gentiana Hasanaj e sistemuar në vendin e punës, mësimdhënëse e mësimit klasor (1-5) në SHFMU "Bajram Curri" në Istog i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muajve, pushimi fillon me 26.06.2026 e deri me 25.06.2027.

II. Sipas pikës 3 të nenit 49, gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë paguhen nga punëdhënësi 70% nga paga bazë duke filluar nga 26.06.2026 e deri me 25.12.2026.

III. Sipas pikës 4 të nenit 49 , tre muajt vijues të pushimit të lehonisë paguhen nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në nivel të Kosovës duke filluar nga data 26.12.2026 e deri me 25.03.2027.

IV. Sipas pikës 5 të nenit 49, lehona ka të drejtë të zgjasë pushimin e lehonisë edhe për tre muaj por pa pagesë.

V. Sipas pikës 6 të nenit 49, nëse lehona nuk dëshiron të shfrytëzoj të drejtën sipas pikës 4 dhe 5 është e obliguar që 15 ditë para skadimit të pushimit sipas nenit 3 të lajmëroj punëdhënësin për fillim të punës.

Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria Komunale e Arsimit, SHFMU "Bajram Curri" Istog dhe Mësimdhënësja.

Vendimi i dërgohet:

-Mësimdhënësen Gentiana Hasanaj;
-Drejtorisë Komunale të Arsimit;
-Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
-SHFMU "Bajram Curri" Istog.

Zyrtari i Lartë Ligjorë
Sami Metaj

Kryetari i Komunës
z.Ilir Ferati

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.822/2026
Data: 30.06.2026

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 05.Nr.382/2026 të datës 30.06.2026, të parashtruar nga Naim Behlulaj-Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit, për lirimin e hapësirave të jashtme të shkollave që të shfrytëzohen për parkingje ne muajt e verës, dhe nxjerr këtë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 05.Nr.382/2026 e datës 30.06.2026, e parashtruar nga Naim Behlulaj-Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit, për lirimin e hapësirave të jashtme të shkollave të cilat kanë hapësira të mjaftueshme qe të shfrytëzohen për parkingje ne muajt e verës, për shkak të fluksit të shumtë të bashkatdhetarëve që vijnë nga diaspora.

2. Obligohen Drejtorët e shkollave të cilat kanë hapësira të mjaftueshme në shkollat e tyre, ti lejojnë për shfrytëzim parkingje në muajt e verës e atë nga data 01.07.2026 e deri me datën 31.08.2026.

3. Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Drejtorët e shkollave.

4. Ky Vendim është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Drejtorisë Komunale të Arsim
-Drejtorëve të shkollave dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Zyrtari i Lartë Ligjorë
Sami Metaj

Kryetari i Komunës
z.Ilir Ferati

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOG
REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.821/2026
Data: 30.06.2026

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 58 shkronja b), c), e), f) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/2010 të miratuar me datën 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **AUTORIZOHET**: Genc Ademaj - Nënkryetar i Komunës që në emër dhe për llogari të Komunës së Istogut të nënshkruaj Marrëveshjen e Ndërmjetësimit në procedurën e ndërmjetësimit që zhvillohet në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Istog, lidhur me çështjen e iniciuar nga pala Zymer Kurpalaj, e evidentuar me nr. të lëndës C.Nr.206/2025 dhe me nr. të ndërmjetësimit Nd.155/26

2. I autorizuari nga pika 1 i këtij vendimi është i autorizuar të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale që lidhen me arritjen dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Ndërmjetësimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesin e Komunës së Istogut.

3. Ky Autorizim vlen vetëm për procedurën e ndërmjetësimit të përshkruar në n pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të Kryetarit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Genc Ademaj.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
- Genc Ademaj,
- Gjykatës Themelore Pejë-Dega në Istog, dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

UD.Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim METAJ

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOG
REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 818/2026 http://kk.rks-gov.net/istog/
Data: 26.06.2026

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13, Nenin 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008) dhe bazuar në Nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010, shqyrtoj kërkesën 09Nr.59/2026 të datës 25.06.2026, të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, për themelimin e Shtabit Komunal për Korrje-Shirje, për realizimin e korrje-shirjeve të drithërave të bardha në territorin e Komunës së Istogut, nxjerr:

V E N D I M

1. **THEMELOHET:** Shtabi Komunal për Korrje-Shirje për realizimin e korrje-shirjeve të drithërave të bardha në territorin e Komunës së Istogut, në Shtab caktohen:

1.1 **Artan Gegaj,** Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Kryesues i Shtabit;
1.2 **Xhevat Demaj,** Drejtor i Drejtorisë për Emergjenca, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar;
1.3 **Fadil Kabashi,** Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, anëtar;
1.4 **Xhavit Blakaj,** Udhëheqës i Sektorit për Inspekcion, anëtar;
1.5 **Skender Hasangjekaj,** Udhëheqës i Sektorit për Siguri dhe Emergjenca, anëtar;
1.6 **Valbone Kaliqani,** Zyrtare e Lartë për Pemëtari, anëtare;
1.7 **Haki Belaj,** Inspektor për Parandalimin nga Zjarri, anëtar;
1.8 **Qendrim Kajtazaj,** Zyrtar i Zhvillimit Rural dhe Subvencione, anëtar.

2. Shtabit Komunal për Korrje-Shirje të drithërave të bardha, obligohet të përcjell korrje-shirjet që të realizohen me sukses dhe në afat në tërë territorin e komunës; të gjitha mosmarrëveshjet në mes të kombajnerëve dhe fermerëve ti zgjidhin me marrëveshje në mënyrë paqësore; të njoftojnë rregullisht Kryetarin me punën e korrje-shirjeve si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij Shtabi Komunal.
3. Obligohet Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të organizoj takime me fermerët, kombajneret dhe deponuesit. Në këto takime të shpërndahen materialet udhëzuese dhe informuese për masat që duhet ndërmarrë për mbrojtje nga zjarri dhe incidentet tjera.
4. Të gjitha punët administrative-teknike për nevoja të Shtabit do ti kryej Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Shtabi Komunal dhe Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
6. Ky vendim është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Shtabit Komunal për Korrje-Shirje;
-Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural; dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

UD. Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim METAJ

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPSTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.816/2026
Data: 26.06.2026

Duke vendosur sipas njoftimit Nr.81/26 të datës 26.06.2026 të ndërmjetësuar nga drejtoresha e IP-së "Shpresa Jonë" në Banjë për konfirmimin e pushimit të lehonisë për edukatoren znj.Shkodrane Bruqaj, lidhur me këtë Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 49. pika 1. e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 13 Rregullores (QRK) NR. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik merr këtë:

V E N D I M

I. znj.Shkodrane Bruqaj e sistemuar në vendin e punës, edukatore në IP "Shpresa Jonë" në Banjë i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muajve, pushimi fillon me 23.06.2026 e deri me 22.06.2027.

II. Sipas pikës 3 të nenit 49, gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë paguhen nga punëdhënësi 70% nga paga bazë duke filluar nga 23.06.2026 e deri me 22.12.2026.

III. Sipas pikës 4 të nenit 49 , tre muajt vijues të pushimit të lehonisë paguhen nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në nivel të Kosovës duke filluar nga data 23.12.2026 e deri me 22.03.2027.

IV. Sipas pikës 5 të nenit 49, lehona ka të drejtë të zgjasë pushimin e lehonisë edhe për tre muaj por pa pagesë.

V. Sipas pikës 6 të nenit 49, nëse lehona nuk dëshiron të shfrytëzoj të drejtën sipas pikës 4 dhe 5 është e obliguar që 15 ditë para skadimit të pushimit sipas nenit 3 të lajmëroj punëdhënësin për fillim të punës.

Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria Komunale e Arsimit, IP "Shpresa Jonë" Banjë dhe Edukatorja.

Vendimi i dërgohet:

-Edukatores Shkodrane Bruqaj;
-Drejtorisë Komunale të Arsimit;
-Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
-IP-së "Shpresa Jonë" Banjë.

Zyrtari i Lartë Ligjorë
Sami Metaj

Kryetari i Komunës
z.Ilir Ferati

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Istogut
Skupstina Opstine
Municipal Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01.Nr.815/2026
Data: 26.06.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 67 pika 1.4 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe nenit 73 pika 1.4 e Ligjit 08/L-197 për Zyrtaret Publikë nxjerr ketë:

VENDIM PËR PËRFUNDIMIN E SHËRBIMIT
P E N S I O N I M I

DETALET PËRSONALE TË SHËRBYESIT:

Emri dhe mbiemri : Ahmet Haxhiu

Data,muaj dhe viti i lindjes: 17.07.1961

Numri i punëtorit : EM-00058616

Kodi i titullit: GJ 51- 4.76

Titulli i pozitës : Punëtor teknik (Roje Objekti)

Shkolla: SHFMU "Tre Dëshmoret e Shkollës Shqipe" Uçë

Lokacioni : Uçë

Komuna: Istog

Data e përfundimit të shërbimit: 17.07.2026

Arsyeja e përfundimit të shërbimit: Pensionimi

Pensionimi – Në bazë të Ligjit të Punës Nr.03/L-212,kreu u VIII,neni 67,paragrafi 1(1.4) i ka plotësuar kushtet e pensionimit.
Zbritje tjera /shtesa në pagesën përfundimtare - nuk ka

Zyrtari i Lartë Ligjorë
Sami Metaj

Kryetari i Komunës
Ilir Ferati

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr. 812/2026
Data: 23.06.2026

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën 06Nr-553-20086 të datës 18.06.2026 të parashtruar nga Senad Šabović nga fshati Dobrushë Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për kompensim te derivateve për transport ne shërbimin e Onkologjisë pran QSKUK-së me procesverbal. Nr.192/2026 të datës 23.06.2026 nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 06Nr-553-20086 e datës 18.06.2026 e parashtruar nga Senad Šabović për përkrahje me karburant për trajtimin për shërbimin ne Onkologji ne QSKUK-së për trajtimin e kimioterapisë ne QKUK dhe përkrahet për **(6)fraksione** nga 15 litra karburant për një seancë, dhe i ndahen **nëntëdhjetë (90)** litra karburant.

2. Obligohet Zyrtari i transportit që Senad Šabović të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Senad Šabović
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

UD.Udhëheqës i Sektorit Ligjor
Afrim METAJ

Kryetari i Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr. 811/2026
Data: 23.06.2026

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën 06Nr-553-20228 të datës 19.06.2026 të parashtruar nga Sadat Isenaj nga fshati Dubravë Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për kompensim te derivateve për transport ne shërbimin e Onkologjisë pran QSKUK-së me procesverbal. Nr.193/2026 të datës 23.06.2026 nxjerr:

VENDIM

1. MIRATOHET: kërkesa 06Nr-553-20228 e datës 19.06.2026 e parashtruar nga Sadat Isenaj për përkrahje me karburant për trajtimin për shërbimin ne Onkologji ne QSKUK-së për trajtimin e kimioterapisë ne QKUK dhe përkrahet për **(10)fraksione** nga 15 litra karburant për një seancë, dhe i ndahen **njëqindepesëdhjetë (150)** litra karburant.

2. Obligohet Zyrtari i transportit që Sadat Isenaj të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Sadat Isenaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

UD.Udhëheqës i Sektorit Ligjor
Afrim METAJ

Kryetari i Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E ISTOGUT * OPŠTINA ISTOG * REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01.Nr. 810 / 2026
Datë: 23.06.2026

Kryetari i Komunës, në harmoni me nenin 13, nenin 17 shkronja (k) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 13, neni 18 paragrafi 1 lidhur me nenparagrafin 1.1, neni 20 paragrafi 5, neni 30, si dhe neni 31 paragrafi 1 dhe 2 i Udhëzimit Administrativ (MD) Nr.03/2025 Për Strehim Rezidencial , si dhe Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.08/L-255, i datës 05.01.2024, Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për Pranimin e Rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare (SHPMPF) me bazë në Gurrakoc, shqyrtoi kërkesën e evidentuar sipas shenjës Nr.06-016-15924 të datës 19.05.2026, të parashtruar nga Qendra për Punë Sociale në Pejë, më kërkesë për lejimin e strehimit institucional në (SHPMPFK) në Gurrakoc, për znj.Ajrija (Shaban) Hysenaj adresa e vendbanimit fsh. Katund i Ri K Pejë, pas rekomandimit nga komisioni Kryetari nxjerrë ketë:

V E N D I M

1.MIRATOHET: Kërkesa Nr.06-016-17138 e datës 29.05.2026, e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale në Pejë më kërkesë për lejimin e strehimit institucional në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare (SHPMPF) në Gurrakoc, K, Istog për znj.Ajrija (Shaban) Hysenaj me nacionalitet shqiptar, me shtetësi Kosovare e identifikuar sipas nr. personal 1001192422 i lindur me 29.06.1955 në fsh. Veriq K, Istog tani më vendbanim në fsh. Katund i Ri K, Pejë.

2.znj.Ajrija (Shaban) Hysenaj i mundësohet vendosja në (SHPMPF) në Gurrakoc në periudhë kohore prej 1 (një) viti.

3.Shtëpia e Komunitetit në Gurrakoc ((SHPMPF) është përgjegjëse për përkujdesjen ndajë znj.Ajrija (Shaban) Hysenaj gjatë qëndrimit në këtë institucion.

4.Obligohet Organi i Kujdestarisë pranë QPS-së në Pejë ta përgatis rezidenten për vendosje, ta bartë dosjen e klientit në shtëpinë e Komunitetit në Gurrakoc dhe ta mbikëqyre gjendjen e rezidentit në shtëpinë e komunitetit në vazhdimësi.

5.Vendimi është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

Arsyetim

Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Kërkesave për Pranimin e Rezidentëve në kuadër të (Drejtorisë për Mirëqenie Sociale) shqyrtoj kërkesën Nr.06-016-15924 e datës 19.05.2026 e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale në Pejë, për strehimin e znj.Ajrija (Shaban) Hysenaj, adresa e vendbanimit fsh. Katund i Ri K, Peje. E lartcekura jeton në shtëpinë e ish bashkëshortit dhe e njëjta ka nevoje për mbikëqyrje përkujdesje të vazhdueshme, pasi që është e pa aftë për tu kujdesur për vetën bazuar në anamnezën sociale të paraqitur në shkresat e lendes nga QPS në Pejë.
Gjendja shëndetësore e tije për momentin është e mirë pa probleme mendore, bazuar edhe në raportet e mjekëve specialist si dhe raportin zyrtar nga QPS në Pejë, pa përkujdesje pasi qe nuk ka bashkëshorte, fëmije biologjik as të adoptuar.
Komisioni për shqyrtimin konstaton se kërkesa e lartcekur është e bazuar në legjislacionin në fuqi dhe gjen mbështetje të plotë në Udhëzimin Administrativ (MD) Nr.03/2025 Për Strehim Rezidencial , si dhe Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.08/L-255, andaj edhe rekomandon vendosjen e znj.Ajrija (Shaban) Hysenaj në (SHPMPF) me bazë në Gurrakoc.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Vendimi është përfundimtar. Pala e pakënaqur me vendimin mund të parashtrojë ankesë në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave.

Më kopje të vendimit të njoftohen :
Znj.Shpresa Lukaj U.D , Drejtor i QPS-ës në Pejë
z.Haki Ibrahimaj, Drejtor i QPS-së në Istog,
Shtëpia e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare (SHPMPF) në Gurrakoc,
Drejtoria për Mirëqenie Sociale si dhe,
Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Zyrtar ligjor për çështje Pronësore
Blerim Ukaj

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01.Nr. 809 / 2026
Datë: 23.06.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës, në harmoni me nenin 13, nenin 17 shkronja (k) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 13, neni 18 paragrafi 1 lidhur me nenparagrafin 1.1, neni 20 paragrafi 5, neni 30, si dhe neni 31 paragrafi 1 dhe 2 i Udhëzimit Administrativ (MD) Nr.03/2025 Për Strehim Rezidencial , si dhe Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.08/L-255, i datës 05.01.2024, Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për Pranimin e Rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare (SHPMPF) me bazë në Gurrakoc, shqyrtoi kërkesën e evidentuar sipas shenjës Nr.06-016-17138 të datës 29.05.2026, të parashtruar nga Qendra për Punë Sociale në Mitrovicë,më kërkesë për lejimin e strehimit institucional në (SHPMPFK) në Gurrakoc, për z.Halil (Haxhi) Sahiti adresa rruga " Shala" Nr.44 Mitrovicë, pas rekomandimit nga komisioni Kryetari nxjerrë ketë:

V E N D I M

1.MIRATOHET: Kërkesa Nr.06-016-17138 e datës 29.05.2026, e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale në Mitrovicë më kërkesë për lejimin e strehimit institucional në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare (SHPMPF) në Gurrakoc, K, Istog për z.Halil (Haxhi) Sahiti, me nacionalitet shqiptar, me shtetësi Kosovare i identifikuar sipas nr. personal 1008371748 i lindur me 10.04.1944 në fsh. Kopiliq i Epërm K, Skenderaj tani më vendbanim në Mitrovicë adresa rruga " Shala " Nr.44.

2.z.Halil (Haxhi) Sahiti i mundësohet vendosja në (SHPMPF) me bazë në Gurrakoc në periudhë prej 1 (një) viti.

3.Shtëpia e Komunitetit në Gurrakoc ((SHPMPF) është përgjegjëse për përkujdesjen ndajë z.Halil (Haxhi) Sahiti gjatë qëndrimit në këtë institucion.

4.Obligohet Organi i Kujdestarisë pranë QPS-së në Mitrovicë ta përgatis rezidentin për vendosje, ta bartë dosjen e klientit në shtëpinë e Komunitetit në Gurrakoc dhe ta mbikëqyre gjendjen e rezidentit në shtëpinë e komunitetit në vazhdimësi.

5.Vendimi është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

Arsyetim

Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Kërkesave për Pranimin e Rezidentëve në kuadër të (Drejtorisë për Mirëqenie Sociale) shqyrtoj kërkesën Nr.06-016-17138 e datës 29.05.2026 e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale në Mitrovicë, për strehimin e z.Halil (Haxhi) Sahiti i cili jeton në Mitrovicë me adresë të lartcekur në një banesë të disa të afërm (familjar) dhe i njëjti ka nevoje për mbikëqyrje përkujdesje pasi që është i pa aftë për tu kujdesur për vetën.
Gjendja shëndetësore e tije për momentin është e mirë pa probleme mendore, bazuar edhe në raportet e mjekëve specialist si dhe raportin zyrtar nga Komuna e Mitrovicës, pa përkujdesje pasi qe nuk ka bashkëshorte, fëmije biologjik as të adoptuar.
Komisioni për shqyrtimin konstaton se kërkesa e lartcekur është e bazuar në legjislacionin në fuqi dhe gjen mbështetje të plotë në Udhëzimin Administrativ (MD) Nr.03/2025 Për Strehim Rezidencial , si dhe Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.08/L-255, andaj edhe rekomandon vendosjen e z.Halil (Haxhi) Sahiti në (SHPMPF) me bazë në Gurrakoc.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Vendimi është përfundimtar. Pala e pakënaqur me vendimin mund të parashtrojë ankesë në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave.

Më kopje të vendimit të njoftohen :
z.Gani Mustafa , Drejtor i QPS-ës në Mitrovicë
z.Haki Ibrahimaj, Drejtor i QPS-së në Istog,
Shtëpia e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare (SHPMPF) në Gurrakoc,
Drejtoria për Mirëqenie Sociale si dhe,
Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Zyrtar ligjor për çështje Pronësore
Blerim Ukaj

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

01 Nr.808 /2026
Data: 23.06.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën 09 Nr.53/2026 të datës 19.06.2026 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, për lejimin e qasjes në sistemin e aplikimit në MBPZHR të zyrtarëve në mënyrë që të realizohen të gjitha aplikimet për pagesa direkte-subvencione të fermerëve për vitin 2026, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** Kërkesa 09Nr.53/2026 e datës 19.06.2026 e parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, për lejimin e qasjes në sistemin e aplikimit në MBPZHR, qe zyrtarëve t`ju hapet ussername në mënyrë që të realizohen të gjitha aplikimet për pagesa direkte të fermerëve për vitin 2026 dhe caktohen zyrtarët si me poshtë:

   1.1. Valbone Kaliqanaj, zyrtare e lartë për pemëtari;
   1.2.Gentrita Salihaj, zyrtare për mbikëqyrje dhe kontroll të tokës bujqësore;
   1.3. Kaltrina Kukleci, zyrtare për blegtori;
   1.4. Qendrim Kajtazaj, zyrtar për zhvillim rural;
   1.5. Diana Blakqori, zyrtare e lartë për bujqësi;
   1.6. Qazim Haxhiu, zyrtar për ujitje dhe kullim.

2. Obligohen të gjithë zyrtarët si në pikën 1 të këtij Vendimi, t`i kryejnë aplikimet e fermerëve për pagesa direkte-subvencione për vitin 2026 dhe ussername-in ta përdorin sipas Ligjeve, UA dhe Rregulloreve në fuqi të Ministrisë Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Zyrtarët dhe Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

4. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
- Të përmendurve në pikën 1 të këtij vendimi,
- Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural,
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

UD.Udhëheqës i Sektorit Ligjor
z.Afrim METAJ

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS ② KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr.807/2026
Data: 22.06.2026

Kryetari i Komunës, në bazë të Nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), bazuar në Nenin 69 paragrafi 4 i Statusit të Komunes 01.Nr62/2010 i miratuar me datën 30.11.2010 si dhe bazuar ne Neni 8 paragrafi 3 të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoj kërkesën 09.Nr.50/2026 te datës 18.06.2026 për themelimin e komisionit për vlerësimin e projekteve konkurruese të OJQ sipas thirrjes publike 09Nr.34.2026 datë 20.05.2026, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për vlerësimin e aplikimeve të OJQ-ve, për realizimin e aktivitetit tradicional "Të Qethat 2026" dhe "Dita e Mollës 2026"dhe në komision caktohen:

1.1. **Kaltrina Kukleci**, Kryesuese e Komisionit;
1.2. **Valza Gusturanaj**, anëtare;
1.3. **Qendresa Maxharri**, anëtare;
1.4. **Valon Bajraktari**, ekspert i jashtëm anëtar;
1.5. **Armend Gashi**, përfaqësues i OJQ-së anëtar;

2. Anëtare rezervë caktohet:
2.1. **Bukurije Visoqi,**

3. Komisioni i cekur me lartë ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha projekteve konkurruese në bazë të thirrjes publike për mbështetje financiare të OJQ-ve: për aktivitetit tradicional "Të Qethat 2026" dhe "Dita e Mollës 2026" pas vlerësimit të projekteve të përpiloj listën me renditje sipas pikëve të fituara të OJQ-ve; me një kopje të listës me përfitues të njofton Kryetarin e Komunës si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

5. Vendimi është përfundimtar

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit,
- Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dhe
-Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Zyrtar Ligjor
Betim FETAHAJ

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOG
REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 804 /2026
Datë: 22.06.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13, nenin 17 pika k) dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar ne nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010 i miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 06.Nr.53/2026 e datës 22.06.2026 parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale, për ndarjen e mjeteve buxhetore për pagesë të qirasë, bazuar sipas Kontratës për qira 01.Nr.806/2026 të datës 22.06.2026 dhe i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerr:

V E N D I M

MIRATOHET: kërkesa 06.Nr.53/2026 e datës 22.06.2026, e parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale, për ndarjen e mjeteve buxhetore sipas Kontratës për pagesën e qirasë mujore evidentuar sipas shenjës 01.Nr.806/2026 e datës 22.06.2026 dhe i ndahen mjete buxhetore për pagesën e qirasë për znj.Blerta Bajramaj, në lartësi të shumës prej 1200€ **(njëmijedyqind euro) për gjashtë (6) muaj.**

Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga 200€ (dyqind euro) në muaj, për gjashtë muaj direkt në llogarinë bankare të qiramarrëses (shfrytëzueses) znj.Blerta Bajramaj - nga programi buxhetor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nenëprogrami buxhetor shërbime sociale.

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

Vendimi është përfundimtarë.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi në parim nuk lejohet ankesë. Pala e pa kënaqur me vendimin mund të paraqesë padi për fillimin e konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative ne afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas ditës së pranimit të këtij vendimi.

Më kopje të vendimit të njoftohen ;

-Drejtoria për Mirëqenie Sociale,
-paraqitësja e kërkesës,
-Arkivi i zyrës së Kryetarit

Zyrtar ligjor për çështje Pronësore
Blerim UKAJ

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOG
REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01.Nr. 803/ 2026
Datë: 22.06.2026

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13, nenin 17 pika k) dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar ne nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01.Nr.62/2010 i miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 06.Nr.53/2026 të datës 22.05.2026, të parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale, për ndarjen e mjeteve buxhetore sipas Kontratës për qira 01.Nr.805/2026 e datës 22.06.2026 dhe i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerr :

V E N D I M

MIRATOHET: kërkesa 06.Nr.53/2026 e datës 22.06.2026, e parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale, për ndarjen e mjeteve buxhetore sipas Kontratës për pagesën e qirasë mujore evidentuar sipas shenjës 01.Nr.804/2026 e datës 22.06.2026 dhe i ndahen mjete buxhetore për pagesën e qirasë për znj.Shukrije Dani në lartësi të shumës prej **900€ (nëntëqind euro) për gjashtë (6) muaj.**

Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga 150€ (njëqindepesëdhjetë euro) në muaj, për gjashtë muaj kalon direkt në llogarinë bankare të qiradhënësit znj.Shqiponjë Beqiraj - nga programi buxhetor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nenëprogrami buxhetor shërbime sociale.

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

Vendimi është përfundimtarë.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi në parim nuk lejohet ankesë. Pala e pa kënaqur me vendimin mund të paraqesë padi për fillimin e konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative ne afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas ditës së pranimit të këtij vendimi.

Më kopje të vendimit të njoftohen ;

-Drejtoria për Mirëqenie Sociale,
-paraqitësja e kërkesës,
-Arkivi i zyrës së Kryetarit

Zyrtar ligjor për çështje Pronësore
Blerim UKAJ

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E ISTOGUT * OPŠTINA ISTOG * REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.802/2026 http://kk.rks-gov.net/istog/

Data: 22.06.2026

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 39 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën e parashtruar nga P.M.N të datës 19.06.2026 të parashtruar nga Prokurimi për themelimin e Komisionit verifikues të aktivitetit për projektin: Lot 1-Ndertimi i rrugës në Lubozhdë, Lagjeja Osaj dhe Pepaj dhe LOT-4 Ndertimi i rrugës në Rakosh, Lagjeja Haxhijaj, Jahaj dhe Brahimaj me numër të jashtëm prokurimi 633-25-5290-5-2-1/C1008 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-025-029-521, nxjerr:

V E N D I M

1. EMROHET: Komisioni verifikues i aktivitetit për projektin: Lot 1-Ndertimi i rrugës në Lubozhdë, Lagjeja Osaj dhe Pepaj dhe LOT-4 Ndertimi i rrugës në Rakosh, Lagjeja Haxhijaj, Jahaj dhe Brahimaj me numër të jashtëm prokurimi 633-25-5290-5-2-1/C1008 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-025-029-521 dhe në komision caktohen.

1.1. Alban Llapi , Kryesues i Komisionit,
1.2 Migjen Maxharraj, anëtar;
1.3. Ardon Arifaj, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë verifikimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit për projektin, 633-25-5290-5-2-1/C1008 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-025-029-521 sipas pikës një të këtij vendimi, me qellim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtaret e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.
